



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 15/2022 (JR)

Nr. 15/2 regj.

Tiranë më 25 .09. 2024

SHPALLJE

E

NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet e procesit, si dhe të gjithë personat e interesuar, se **ditën e martë, datë 15.10.2024, ora 10:00**, do të shqyrtohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh çështja me nr. regjistri (JR) nr. 15/2022, datë 11.03.2022, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Artan Lulaj kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 497, datë 13.01.2022.

Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë.
Trupi Gjykues, përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesues i Trupit Gjykues	Sokol Çomo
Relatore e Çështjes	Ina Rama
Gjyqtare	Albana Shtylla
Gjyqtare	Natasha Mulaj
Gjyqtare	Mimoza Tasi

Bazuar në nenin 49, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim.

Bazuar në nenin 482, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit të çështjes, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

KRYESUES I TRUPIT GJYKUES
GJYQTAR

SOKOL ÇOMO

